



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2019:285174

Datë: 18.04.2023

Numri i dokumentit: 04235301

P.nr. 1/20

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-Divizioni Penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me pjesëmarrjen e praktikantes Edona Salihu në cilësinë e procesmbajtëses, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.Z. nga fsh ....., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, të evidentuar me PP.II.nr. 2124-1/19 të datës 30.12.2019, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor publik me datë 27.03.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini, të dëmtuarit Xh.H. dhe të akuzuarit, ndërsa me datë 29.03.2023 mori dhe publikisht shpalli kurse me datë 18.04.2023 përpiloi me shkrim këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari D.Z., nga i ati F. dhe e ëma B., e gjinisë N., i lindur më ....., me vendbanim në fsh....., Komuna Ferizaj, me nr. personal ....., i martuar, baba i tre fëmijëve, me profesion punëtor sigurimi, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë për veprë tjetër penale lëndim i lehtë trupor, mbrohet në liri.

## S E P S E

Me datë 09.08.2019, rreth orës 15:00 në restorantin “P.M.” në rrugën “...” në Ferizaj, i pandehuri deri sa ishte duke punuar punëtor sigurimi, fillimisht kishte kërkuar nga i dëmtuari Xh.H.a të largohet nga marketi, pasi që i dëmtuari kishte ngacmuar punëtoren A.Z., i dëmtuari kishte refuzuar, ndërsa i pandehuri duke e larguar e rrëzon në tokë, meqë rast i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin, në formë të ndrydhjeve të indeve të buta dhe gjakmbledhje nënlëkurore në bërrylin e majtë, nyjën e shuplakës së djathtë dhe gërvishtje sipërfaqësore të lëkurës në dorën e djathtë, të cilat janë të konstatuara si në Akt ekspertimin mjeko - ligjor të datës 10.12.2019.

**Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nen par 1.4 të KPRK-së.**

Andaj gjyqtari i vetëm gjykues, në kuptim të nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe 185 par 1 të KPRK-së, si dhe neneve 364 dhe 449 par. 2.6 dhe 2.9 dhe neni 462 të KPPRK-së, të akuzuarën e:

## G J Y K O N

Me dënim me gjobë, në shumë prej 200 € /dyqind euro), të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro (njëzet euro), për shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjeko ligjore) në shumë prej 20 € / njëzet Euro si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 /njëzet/ Euro, që të tri shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit me dhunë.

I dëmtuari Xh.I., S. H. nga fsh. ...., K. Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

### Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore ne Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr. 2124-1/19 të datës 30.12.2019, kundër të akuzuarit për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nen par 1.4 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtores dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës, me datë 27.03.2023, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën seance kane prezantuar prokurori i shtetit, i dëmtuara dhe i akuzuari.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tija në kuptim të nenin 319 par.2 të KPPRK-së. Dhe pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata ka deklaruar se heqë dorë nga leximi i aktakuzës pasi që një kopje të saj e kam pranuar në shqyrtimin fillestar dhe njëjta në këtë rast edhe më është lexuar nga prokurori e shtetit dhe për këtë nuk kam nevojë të me lexohet pasi që atë e kam të krejtësisht të qartë, gjyqtari pasi që është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, konform nenit 321 paragrafi 1 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë në shqyrtim gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues, ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor me administrimin e provave materiale, mbrojtjen e të akuzuarit si dhe fjalën përfundimtare të palëve, për të përfshirë kështu, të gjitha faktet dhe provat që i ka konsideruar të rëndësishme për një gjykim të saktë dhe të drejtë.

### Provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësor

Në shqyrtimin gjyqësor janë administruar provat materiale si, Raporti i oficerit nr. 2019-CF... i dt. 09.8.2019, Deklarata e dëshmitares A.Z., e dt.27.6.2019, Deklarata e të dëmtuarit e dt.16.8.2019, Deklarata e të pandehurit e dt.20.8.2019, Akt Ekspertimi mjeko-ligjor i dt. 10.12.2019, i punuar nga Dr. B.C., Raporti i Spitalit të Përgjithshëm – Qendra Emergjente në Ferizaj nr. ..., i dt. 09.09.2019 për të dëmtuarin si dhe shkresat tjera të lëndës.

Gjykata për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të saktë të gjendjes faktike, ka dëgjuar dëshmitarin-dëmtuarin, i cili në cilësinë e dëshmitarit ndër të tjerash ka theksuar se më kujtohet që diku para dy-tri viteve, rrethe orës 10,00 kam qenë duke pirë kafe në Restoranin e ....., në Ferizaj dhe atë pasi më parë pata blerë disa gjëra ushqimore në market dhe ndërkohë aty ka erdh i pandehuri me dy shok te tij dhe i pandehuri ma ka ngjitur me duar në tesha dhe me ka thënë “Qu plak prej këtuhit mos te shohim këtu “ dhe pastaj ma ka dredhur krahun dhe më ka ngreh zhag dhe me dy shok të tij të cilët më kanë shtyrë më kanë qitur dhunshëm jashtë marketit në asfalt dhe unë nga shtytja që ma kanë bërë jam rrëzue në asfalt dhe e kam lëndua dorën, të njëjtit nuk më lejojshin me u ngrit për me marr veturën por më shtyjshin dhe më thoshin mos të shohim më këtu dhe një shokë i tij i tha të pandehurit boll mos e tepro dhe pas kësaj janë larguar, unë pastaj jam ngritur ngadalë dhe e kam thirrur policin te cilët kanë ardhur dhe më kanë dërguar në Emergjencën e Spitalit të Përgjithshëm në Ferizaj, e pastaj kamë dhënë deklaratë për rastin në polici. Unë para ndodhjes së këtij rasti nuk kamë pasur kurrfarë problemi me asnjë punëtor të marketit dhe asë qe kam nguxur ndonjë punëtor të këtij marketi, më pas prapë ka shkuar në të njëjtin market dhe edhe tani shkoj ne të njëjtin market dhe e kam pa të pandehurin por nuk kamë pas problem me te.

Ndërsa dëshmitarja A.S., në deklaratën e saj të dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj me dt. 27.06.2019, ka deklaruar se diku në muajin korrik të vitit 2019, gjersa isha në vend të punës në “.....” dhe atë tek gjërat e konservuara ka ardhur një person- myshteri i moshës rreth 50 vjeçar, i cili fillimisht më ka pyetur për disa gjëra të konservuara e pastaj më ftoj për të pirë kafe me te, unë refuzova dhe i thash se ti mundsh me qenë babai im, e pastaj i njëjti u largua, mirëpo i njëjti nga ajo ditë e gjerë me dt. 09.08.2019 çdo ditë nga ora 14:45 ka ardhur në “.....” dhe çdo herë më ka ngacmuar me fjalë. Ndërsa me dt. 09.08.2019, rreth orës 15:00 i njëjti prapë ka ardhur në market dhe më është afruar dhe ka filluar të më ngacmoj me fjalë, ndërsa unë në pamundësi ta toleroj atë e kam lajmëruar punëtorët e sigurimit të marketit dhe pastaj të njëjtit janë afruar tek personi në fjalë dhe kanë filluar të bisedojnë me te, ndërsa unë kam vazhduar me punën time, por se çka kanë biseduar në mes vete nuk e di dhe unë nuk i kam vërejtur punëtorë të sigurimit se e kanë kapur për krahu atë persona dhe që e kanë larguar nga marketi pasi që unë isha duke u marrë me punët e mia dhe nuk e di se çka ka ndodhur më tutje dhe pas këtij rasti më personin në fjalë nuk e kam parë asnjëherë në market.

### Mbrojtja e të akuzuarit

Pas administrimit të provave, i akuzuari në mbrojtjen e tij ndër të tjerash ka deklaruar se me datën 09.8.2019, diku pak para orës 15:00, menaxheri i qendrës tregtare ....., në Ferizaj, ku unë punoj punëtor sigurimi ka ardhur dhe më ka njoftuar, se një person i moshës së vjetër po e ngacmon punëtoren A.Z., unë fillimisht kam shkuar te punëtorja në fjalë dhe e kam pyetur se mos ke najsen me qatë personin e vjetër, i cili ishte ende në market, ajo më tha se po më ngacmon me lloj lloj fjalësh dhe po më thotë se në ora tre ke me ardhë me mua, unë me dy punëtorët tjerë të sigurimit A. dhe G. kemi shkuar tek restoranti ku personi në fjalë shkoi për të pirë kafe, dhe unë iu drejtova duke thënë çka ke ti me atë qikën ndërsa i njëjti më tha “ ec largoju prej ktuhi” kurse unë i thashë ec prej ktuhit se unë ta paguaj kafën dhe mos e nguc më atë qiken, i njëjti u largua pak e mori një karrige të plastikës në dorë dhe deshi të më godas, ndërsa unë ia kapa karrigen gjera e kishte të ngritur lart dhe kur unë ia kam ngreh karrigen ai u rrëzua në tokë dhe nuk është ngritur menihërë, por ka qëndruar aty edhe një kohë dhe nuk e di se a ka qenë i lënduar apo jo pasi nuk e kemi shikuar se a ka apo jo lëndim. Nuk është e vërtetë që e kam sulmuar duke ia dredhur krahun apo duke e rrahur siç deklaron i dëmtuari.

### Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, pas dëgjimit të dëmtuarit-dëshmitarit Xh.H., lidhur me rastin e dt.09.08.2019, i cili rast ka ndodhur në restorantin ..., në rruga “...” në Ferizaj, ku i dëmtuari me dëshminë e tij e ka përshkruar në mënyrë shumë bindëse rastin si në aktakuzë dhe i njëjti po ashtu deklaroj se i akuzuari në momentin që e kanë larguar nga marketi për ta qitur jashtë e ka kapur për dore ia ka dredhur dorën dhe si pasojë e këtij veprimi i njëjti ka marrë edhe ndihmë mjekësore në Spitalin e Përgjithshëm-Qendra Emergjente në Ferizaj. Nga provat materiale, Akt ekspertimi mjeko-ligjor punuar nga eksperti mjeko ligjor dr.B.C. të dt.10.12.2019, vërtetohet fakti se si pasojë e lëndimeve të pësura i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore të përshkruara si në këtë akt ekspertim, e të cilat janë bazuar në raportin e lartë cekur mjekësor. Andaj pas administrimit të këtyre provave, mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale që e ngarkon kjo aktakuzë dhe ti shqiptojë sanksion penal të paraparë me ligj. Gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptimi të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së e posaçërisht faktin që i akuzuari është i dënuar edhe më parë për veprë penale lëndim trupor me dënim me gjobë të cilin fakt e mësuam tani nga vet i akuzuari në këtë shqyrtim gjyqësor.

I dëmtuari Xh.H. në fjalën përfundimtare deklaron, e mbështes në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit, i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe po ashtu paraqes kërkesë pasurore juridike.

I akuzuari D.Z., në fjalën përfundimtare deklaron, unë nga ajo që u shqyrtua gjerë më tani konsideroj se jam krejtësisht i pafajshëm, pasi që gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor nuk u dëshmuua me asgjë se unë kam kryer veprën penale që më ngarkon aktakuza. Andaj edhe kërkoj nga gjykata të më lirojë nga përgjegjësia penale.

#### Vlerësimi i dëshmive dhe provave të administruara

Gjykata duke u bazuar në nenin 7, 8 dhe nenin 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, vlerësoi provat një nga një dhe të gjitha së bashku si dhe lidhje me provat që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendja e përshkruar faktike, u vërtetua në bazë të deponimit të dëshmisë së të dëmtuarit-dëshmitarit dhe pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarit dhënë në shqyrtimin gjyqësor dhe nga deklarata e dëshmitares e dhënë në stacion Policor në Ferizaj.

Gjykata nga leximi dhe analizimi i dëshmisë së të dëmtuarit -dëshmitarit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor, vlerëson se dëshmia e tij ishte objektive dhe e saktë, pasi që nëpërmjet saj u vërtetua në mënyrë të pa kontestueshme se i akuzuari në ditën kritike e ka sulmuar fizikisht të dëmtuarin dhe i ka shkaktuar lëndime trupore dhe me tutje gjykata vlerëson se dëshmia e të dëmtuarit-dëshmitarit është e vërtetë dhe reale dhe atë duke e ndërlidhur edhe me mbrojtjen e të akuzuarit i cili pranoi se kishte shtuar tek tavolina e restorantit ku kishte qenë i ulur i dëmtuari dhe kishte kërkuar nga ai që të del jashtë restorantit dhe që më pas kur i dëmtuari kishte një karrige plastike në dorë ia kishte nxjerr karrigen dhe ka pranuar se i dëmtuari në këtë rast është rrezuar në asfalt dhe ka theksuar se ai për një kohë ka qëndruar aty në asfalt dhe nuk e din se a është lënduar apo jo pasi nuk e ka shikuar se ka apo jo lëndime i dëmtuari. Çka vërtetohet se i njëjti nuk e mohon faktin se ka e ka qitur në mënyrë të dhunshme jashtë restorantit të dëmtuarin, se ia ka nxjerrë karrigen dhunshëm nga duart, se i dëmtuari është rrezuar në asfalt dhe në një farë mënyre ka pranuar se ai ka mund të jetë i lënduar. Gjykata vlerëson se deklarimi i të dëmtuarit –dëshmitarit në rastin konkret ishte koherente, e saktë dhe mbi të gjitha e vërtetë, kështu gjyqtari ia fali besimin në tërësi dëshmisë së tij.

### Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit.

Gjyqtari me kujdes të veçantë ka vlerësuar dhe analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit të dhënë shqyrtimin gjyqësor, mirëpo mbrojtja e tij ka qenë e pabazuar, jo objektive, e pa mbështetur në asnjë provë materiale të administruar në shqyrtimin gjyqësor, për më tepër mbrojtja e tij ka qenë e pa argumentuar dhe e paqëndrueshme, për më tepër në shqyrtimin gjyqësor pjesërisht e ka pranuar se në ditën kritike i u ka drejtuar të dëmtuarit me fjalët “ec largohu prej këtuhi” dhe që ka kërkuar nga i dëmtuari të del jashtë restorantit te marketit, se ia ka kapur karrigen nga duart e të dëmtuarit dhe se me këtë rast i dëmtuari është rrëzuar, por ka mohuar se e ka sulmuar fizikisht dhe që i ka shkaktuar lëndime trupore duke theksuar se nuk e di se i njëjti ka pasur apo jo lëndime trupore duke deklaruar se nuk e ka shikuar se a ka pasur apo jo lëndime trupore gjersa ka qenë i rrëzuar në asfalte, gjë që sipas gjykatës nëse këtë deklaram e ndërlidhim me provat tjera të administruara sidomos me dëshminë e të dëmtuarit-dëshmitarit, dhe pjesërisht edhe nga dëshmia e dëshmitares, vërtetohet në mënyrë të pakontestueshme se i njëjti e ka sulmuar dhe lënduar palën e dëmtuar e që kjo dëshmohet edhe nga Raporti mjekësor i palës së dëmtuar, për më tepër gjykata e analizoi edhe personalitetin, karakterin dhe sjelljet e tija në shqyrtimin gjyqësor, dhe konsideroi se i pandehuri nuk shfaqti pendim dhe as kërkim falje për veprën penale të kryer, duke e mohuar në mënyrë kategorike veprën penale dhe duke u përpjekur t’i arsyetoj veprimet e tija, e që me këtë kishte qëllimin që t’i ikë përgjegjësisë penale, ndërsa gjyqtari i vetëm gjykues, një mbrojtje të tillë nuk ia fali besimin dhe kësaj shpalli fajtor për veprën penale që i vihet në barrë.

### Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nen par 1.4 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprës penale për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### Vendimi mbi dënimin dhe shpenzimet procedurale:

Gjykata gjatë shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit, mori në konsideratë dhe vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69, 70 të KPRK-së, të cilat rrethana ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë lehtësuese, kurse si rrethanë renduese gjeti se i akuzuari edhe më parë ka qenë

i dënuar për veprë penale të ngjashme me aktgjykim të formës së prerë dhe atë me aktgjykimin nr. 2022..... të dt. 21.02.2022 dhe përveç kësaj vlerësoi edhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmit që i është shkaktuar vlerës së mbrojtur nga kryerja e kësaj vepre penale. Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e tij, si dhe në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është marruar në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PERGJITHSHËM**  
**P. nr. 1/20, datë 18.04.2023**

**Praktikantja**  
Edona Salihu

**Gjyqtari i vetëm Gjykses,**  
Imri Sejda

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit të Kosovës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Ferizaj.